

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA PEQIN  
NR. 2334 REP. 246 KOL.



### KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Mbahet sot me date 16. 06. 2005, ditën e Enjte , ne zyren e noterise Peqin , perpara meje noteres Enkelejda R. Dervishi , e regjistruar ne dhomen e noterise Durres , me seli ne Peqin , u paraqiten personalisht palet kontratuese :

**SHITESI : Fadil Sinani** , biri Nexhip dhe Honme, dtl.17.06.1957, banues Elbasan lagja "Beqir Dardha" , me cilesine e presidentit te firmes " Sinani " sh.p.k Peqin , me nr. nipt J69405109K dhe nr. kodi fiskal 2700340, mbajtes i pasaportes me n.Z0862094

**BLERESI : Islam Liçi** , biri Aqif dhe Deje, dtl.26.05.1966, lindur dhe banues ne fshatin Lazarej, komuna Pajove - Peqin, identifikuar me pasaporte me nr. 1481186 .

Qe te dy te mesipermit jane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me vullnetin e tyre te lire , dhe ne perputhje me nenin 705 e vijues te K. C. si dhe ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 , " Per shoqerite tregtare" , kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje , me objekt si me poshte :

Shtetasi i mesiperm , i cili paraqitet ne cilesine e shitesit , eshte pronar i ligjshem ne masen 100 % te kuotave te shoqerise " SINANI " sh.p.k Peqin, e cila eshte e regjistruar me vendim Gjykate Tirane , me nr. 5786, date 05.08.1994, e cila ushtron aktivitetin e saj ne fshatin " Çengelaj", komuna Pajove, rrethi Peqin , sipas certifikates se rregjistrimit ne organ tatimor me kod fiskal nr. 2700340 .

Lidhur me sa siper, shitesi i mesiperm , **Z. Fadil Sinani** , me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise " Sinani" sh.p.k Peqin , deklarone ne prezencen time, noteres , **se 50%** te kuotave te shoqerise, ia shet blesesit te mesiperm , **Z. Islam Liçi** , ne vleren 50.000 ( pesedhjetemije) leke te reja. Blesesi deklaroi se pranon blesjen e 50 % te kuotave te kesaj shoqerie, dhe te dy palet pohojne se jane likujduar jashte kesaj zyre noterie , dhe nuk kane pretendime ndaj njeri - tjetrit .

Me redaktimin dhe nenshkrimin nga palet te ketij akti , blesesi fiton pronesine e ligjshme te 50 % te kuotave te shoqerise "Sinani" sh.p.k Peqin , duke patur te drejten ligjore , per tu regjistruar ne aktet e shoqerise , me cilesine e ortakut te kesaj shoqerie , me 50% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie .

Kontrata lexohet dhe nenshkruhet rregullisht nga palet .

Une noteria e gjeta kete akt ne perputhje me vullnetin e paleve dhe te bazuar ne ligj , sipas nenit 705 e vijues te K.C e vertetoj rregullisht sipas ligjit .

SHITESI

*Fadil Sinani*

" SINANI " SH.P.K,  
NDERTIM - MP EXP  
PEQIN ALBANIA

NOTERE  
ENKELEJDA R. DERVISHI

*Enkelejda R. Dervishi*

BLERESI

*Islam Liçi*